



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 1770/3 prot.

Gramsh, më 03/06/2021

VENDIM

Nr. 67, datë 28.05.2021

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.97, DATË 28.12.2020 PËR “MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR QË FREKUENTOJNË NË SHKOLLA PROFESIONALE TË ARSIMIT TË MESËM PUBLIK TË CILËT PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSËS PËR VITIN MËSIMOR 2020-2021”**

Këshilli Bashkiak i mbledhur në datë 28/05/2021 mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 21 pika 1 dhe 3, neni 22 si dhe VKM. nr.666 datë 10.10.2019 për “Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimit publik , për vitin shkollor 2019-2020, pika 2.4 /b (jashtë kriterit ekonomik) për nxënësit me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit ku përfshihet Bashkia Gramsh, si dhe shkresës nr.21839 prot, datë 23.11.2020 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional me banim në juridiksonin e Bashkisë Gramsh, ku numri i bursave të miratuara është 29 (njëzet e nëntë), si dhe në dokumentacionin e paraqitur nga zv/Kryetari i Bashkisë.

**V E N D O S I**

1. Të ndryshojë pikën 1 të listës emërore me **29 (njëzet e nëntë) nxënës** me 100 % B (Bursë të plotë) që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, të regjistruar në vitin e parë shkollor dhe që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës për vitin shkollor 2020-2021, ku në vend të nxënësës Xhonada Tomorr Çekrezi të vendoset Eldjon Valmir Çekrezi.
2. Pikat e tjera mbeten të pandryshuara.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
**Xhulja GJINI**

Konceptoi: Xh.Gjini  
Pranoi: G.Lena  
Miratoi: G.Lena  
Dosja nr:  
Afati i ruajtjes: RHK

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
**Greta LENA**

